


2020



KOMUNA
RAHOVEC



[BULETINI MUJOR KOMUNAL]
SHTATOR 2020

[BULETINI MUJOR KOMUNAL]

PËRMBAJTJA

HYRJE	2
AKTIVITETE TË KRYETARIT DHE DREJTORËVE TË DREJTORIVE.....	3
PËRFUNDIM	16

HYRJE

Ky organ botues është krijuar me idenë fillestare të promovimit të aktiviteteve të Kryetarit të Komunës dhe drejtorëve të drejtoreve përgjatë muajve të vitit 2020, rëndësia e botimit të buletinit disa herë në vit qëndron në dhënien e mundësisë për informacionet mbi vendimet, zbatimin e politikave dhe rezultatet e aktiviteteve të Komunës së Rahovecit në mënyrë të tillë që të mundësojmë që qytetari të ndjekë dhe të kontribuojë në mënyrë efektive në punën e institucioneve lokale.


Edhe muaji shtator i vitit 2020, është karakterizuar me një sërë aktivitetesh, pas shfaqjes së pandemisë COVID-19, situatë kjo e cila ka sjellur mjaft vështirësi edhe në Komunën e Rahovecit.

Me anë të këtij buletini mujor përmuan shtator ne jemi munduar të paraqesim me fotografi dhe në detaje aktivitetet nga ana e Kryetarit të Komunës dhe drejtorëve të drejtoreve në Komunën e Rahovecit.

AKTIVITETE TË KRYETARIT DHE DREJTORËVE TË DREJTORIVE

Është shpallur Konkursi Ndërkombëtar për Dizajnimin e Sheshit Qendror të Rahovecit, një projekt ambicioz për komunën tonë.

Komuna e Rahovecit do t'i qaset me seriozitet këtij projekti deri në realizimin e tij!



Pas përfundimit të të gjitha procedurave, në mënyrë transparante, Kryetari Smajl Latifi ka nënshkruar kontratën për realizimin e projektit "Trajtimi i shtretërve të përrrenjeve në Komunën e Rahovecit", në vlerën: 815,988.10€. Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, sipas kësaj kontrate, do të realizojë projektet e trajtimit të përrrenjeve në këto fshatra: Opterushë, Pataqan i Ulët, Malësi e Vogël dhe Polluzhë.

Është bërë përrurimi i Qendrës së Mjekësisë Familjare në fshatin Çifllak. Vlera e projektit për ndërtimin e Qendrës së Mjekësisë Familjare në Çifllak, buxhetit të komunës së Rahovecit i kushtoi 82,996 €.



[BULETINI MUJOR KOMUNAL]



Kryetari Smajl Latifi ka pritur për një vizitë zyrtare ministrin e Ekonomisë dhe Ambientit z. Blerim Kuçi, me të cilin diskutuan për situatën e përgjithshme në Komunën e Rahovecit dhe fushat ku kërkohet mbështetja nga institucionet qendrore. Përveç temave të ndryshme që u trajtuan në këtë takim, me ministrin Kuçi zyrtarizuan marrëveshjen që të vazhdohet financimi i shtratit të lumiit nga Hoça e Madhe, Brestoc, Hoçë e Vogel, Nagac e deri në Krushë të Madhe në vlerë 1,294.000 nga ana e Ministrisë së Ekonomisë së Ambientit.

Kryetari Latifi ka pritur në takim përfaqësues të fermerëve blegtore të komunës së Rahovecit si dhe pronarin e pikës më të madhe grumbulluese të qumështit "Pashtriku", të cilët i janë drejtuar komunës sonë për të shprehur shqetësimin serioz të tyre për pamundësinë e dorëzimit të qumështit në pika grumbulluese.



Kryetari Smajl Latifi së bashku me drejtorin e arsimit z. Avni Morina dhe me koordinatorin komunal për eficiencë të energjisë z. Shpejtim Mustafa, pritën në drejtorin menaxhues të Fondit të Kosovës për Eficiencë të Energjisë z. Admir Shala. Me z. Shala nënshkruan marrëveshjen për fillimin e zbatimit të projekteve për ndërmarrjen e masave të energjisë eficiente për tri objekte shkollore në komunën tonë.



Shkollat përfituese janë të përfshira në këto projekte, janë:

- Shkolla "Hamëz Thaçi" në Xerxë
- Shkolla "12 Maji" në Ratkoc
- Shkolla "Skënder Kastrati", paralelja e ndarë në Gexhë.

RAHOVECI FITON GRANTIN PËR PERFORMANCËN MË TË MIRE KOMUNALE PËR VITIN 2019- 655,147.23€

Ky çmim është dëshmi për seriozitetin, përkushtimin dhe efikasitetin e ekzekutivit komunal në Rahovec. Kemi edhe shumë punë para veftes, por jemi në rrugë të drejtë për t'u bërë shembull model i qeverisjes lokale në nivel vendi.



Kryetari Smajl Latifi bashkë me zëvendësministren e MPL-së, znj. Magbule Shkodra, bashkëpunëtorë e qytetarë të shumtë morëm pjesë në fillimin e punimeve të projektit për rregullimin e shtratit të përroit në Opterushë. Një projekt i tillë do t'i parandalojë papastërtitë, vërvshimet dhe do të ndikojë në përmirësimin e kushteve mjedisore, duke i dhënë pamjen e merituar kësaj zone.

U mbajt takimi i Task Forcës në Nivel të DKA-së, në të cilën u bisedua për përgatitjet që po bëhen për fillimin e vitit të ri shkollor 2020/2021.



BULETINI MUJOR KOMUNAL



Kryetari Latifi bashkë me drejtorin e arsimit dhe nënkyetarin e komunës, vizituan disa shkolla të komunës sonë për të parë nga afër ecurinë e fillimit të vitit të ri shkollor 2020/2021.



Publikohet “Indeksi i Konkurrueshmërisë së Komunave” Komuna e Rahovecit me performancë të mirë në nivel vendi!



Kryetari Smajl Latifi ka pritur për vizitën ministrin e bujqësisë z.Besian Mustafa, ku bashkë vizituan stallën e Alban Thaçit nga Çifllaku, Kooperativën Bujqësore KB "KRUSHA" dhe ndërrmarrjen "M-Sillosi". Duke parë gjendjen me të cilën po ballafaqohen fermerët tanë nga ministri Mustafa u konfirmua, se brenda mundësive buxhetore do të ofrohet mbështetja për trajtimin e çështjeve me urgjencë si: çështja e grumbullimit dhe pranimit të qumështit, kompenzimi i dëmeve dhe çështja e pranimit të rrushit nga bodrumet dhe përpunuesit.

[BULETINI MUJOR KOMUNAL]



Bashkë me nënkyryetarin Fatmir Iska dhe menaxherët e projekteve, Kryetari Latifi ka takuar operatorët ekonomik që kanë kontrata me komunën e Rahovecit për realizimin e projekteve të ndryshme, qofshin ato infrastrukturore apo shërbime e që janë në të mirë të qytetarëve.

Pas vendimit të fundit të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, që përkohësisht të ndalohet importi i vajit të palmës, gjithashtu, edhe importi i djathit dhe i produkteve të tjera me përbajtje të vajit të palmës, Kryetari Latifi ka ftuar inspektorët komunal që menjëherë të dalin në terren (tashmë ata janë në terren) për mbikëqyrjen e operatorëve ekonomik të cilët tashmë janë të obliguar që të bëjnë ndarjen e produkteve të qumështit me yndyrë bimore(vaj palme), prej atyre me origjinë shtazore.



Kryetari Smajl Latifi bashkë me drejtorin e kadastrës, Afrim Oruqi kanë zhvilluar një takim pune me Kryeshefin Ekzekutiv të AKK-së z. Avni Ahmeti me bashkëpunëtorë. Në takim, pos prezantimit të projektit të Bankës Botërore edhe aktivitetave të ndërsjella, diskutuan edhe mbi të gjeturat e raportit të monitorimit të punëve kadastrale të kryera nga Zyrat Kadastrale Komunale, kompanitë e licencuara gjeodete dhe gjeodetët e licencuar.

Kryetari Latifi ka mbajtur takim e radhës me të gjithë punonjësit e administratës komunale në Rahovec, me të cilët bashkëbiseduan për çështje të ndryshme të organizimit sa më të mirë të punës në të gjithë sektorët, rritjen e përgjegjësisë dhe rregullit nga secili punonjës, respektimin e orarit të punës dhe angazhimin e tyre në kryerjen e punëve më me efikasitet dhe ofrimin e shërbimeve sa më të përparuara, cilësore dhe pa vonesa.



[BULETINI MUJOR KOMUNAL]

U mbajt Festivali Tradicional Kombëtar “Anadrinia Jehon 2020”

Këtë vit për shkak të situatës së krijuar nga pandemia Covid-19, festivali është mbajtur në mënyrë virtuale më datat 25 dhe 26 shtator, për të shpalosur kështu vlerat më të mira popullore të kombit tonë.



FILLOJNË PUNIMET NË PROJEKTIN “NDËRTIMI DHE TRAJTIMI I UJËRAVE ATMOSFERIK NË QYTET”

Projekti: “Ndërtimi dhe trajtimi i ujërave atmosferik në Qytet”, kap vlerën prej 248,702.57€, gjatësia e kanalit do të jetë 560m, kanali si i tillë do të jetë me diametër të paraparë në projekt: 2m me 1.30m, kanal i tipit të mbyllur dhe do të trajtohet me të gjitha elementet përcjellëse. Pas përfundimit të punimeve në kanal, do të rregullohen edhe dy shtresa asfalt.

KUVENDI KOMUNAL I RAHOVECIT MIRATON BUXHETIN PËR VITIN 2021

Në mbledhjen e mbajtur të Kuvendit Komunal është miratuar propozimi i Kryetarit Smajl Latifi për buxhetin e Komunës së Rahovecit për vitin 2021 i cili do të jetë 14,216,590.00 euro.




[BULETINI MUJOR KOMUNAL]



Në prani të nënkyetarit Fatmir Iska dhe drejtoreshës Bjondina Kleqka, Kryetari Smajl Latifi ka nënshkruar kontratën me drejtorin e klubit "KB RAHOVECI", Alban Rama, për ndarjen e mjeteve financiare në mbështetje të KB "RAHOVECI" në vlerën: 22,000.00 euro.



Vazhdojnë punimet në krahun 3 të kanaleve të kullimit të tokave bujqësore në Xerxë. Ruajtja e tokave bujqësore është prioritet i qeverisë së udhëhequr nga kryetari Smajl Latifi.



Po vazhdojnë punimet në ndërtimin e murit mbrojtës në Bërnjakë.



Kryetari i Komunës Smajl Latifi së bashku me drejtorin e DBPZHR-së Berat Duraku, kanë mbajtur takim virtual me Ministrin e MBPZHR-së, Besian Mustafa, të cilët i kanë adresuar disa nga problemet me të cilat po përballen fermerët e komunës sonë.

[BULETINI MUJOR KOMUNAL]

Kryetari Latifi dhe arkitektë nga komuna e Rahovecit, kanë vizituar hapësira të lira komunale, që të sigurohet ndërtimi, administrimi dhe mirëmbajtja e terreneve sportive, parqeve rekreative, historike dhe natyrore brenda territorit të komunës së Rahovecit, në zona të frekuentuara nga çdo grupmoshë.



Nën mbështetjen e DKRS-së në Rahovec, SHL-Kosova dhe Radio Aktiv kanë filluar implementimin e projektit për Radiogazetari, ku marrin pjesë një numër i të rinjëve të komunës së Rahovecit.



Vazhdojnë punimet në rregullimin e infrastrukturës publike. Pamje nga pjesa e punimeve në rrugë, gjatë trajtimit të lëshesave ujore në segmentin e rrugës Sapniq-Nushpal.



Kanë rifilluar punimet në trajtimin e ujërave fekale në fshatin Pastasel. Do të vazhdojmë edhe në fshatrat Senoc dhe vendbanimet tjera dhe lagjet urbane!

[BULETINI MUJOR KOMUNAL]



Segmenti i parë i rrugës në Drenoc, është finalizuar nga punimet. Pamjet e rrugës së ndërtuar.

Përfunduan punimet e rrjetit të kanalizimit në njëren lagje të fshatit Pastasel.



Vazhdojnë punimet në ndërtimin e rrugës, Xërxe-Sapniq-Ratkoc. Janë duke u bërë kanalet për shkarkimin e ujërave atmosferik.



Intervenimet emergjente në infrastrukturë publike! Pamjet e mëposhtme tregojnë ndërhyrjet emergjente në disa pozicione që kanë qenë problematike për qytetarët.

[BULETINI MUJOR KOMUNAL]



Sinjalizimi i vendparkingjeve për persona me aftësi të kufizuara. Vend parkingjet do të vendosen në disa zona të qytetit, që janë parkingje në vende publike.



Është bërë përrurimi i projektit të rrjetit të ndriçimit publik në Dobidol. Qytetarëve të Dobidolit, në kuadër të infrastrukturës i është shtuar tashmë edhe ndriçimi, që rrit edhe sigurinë e tyre.



Intervenimet emergjente në pjesën përgjatë shkollës fillore në Ratkoc.



Kemi përfunduar me largimin e mbetjeve inerte përgjatë rrugës rajonale Rahovec-Malishevë. Si qeverisje komunale mbetemi të përkushtuar në mëdis të pastër.

[BULETINI MUJOR KOMUNAL]



Ka filluar projekti i ndriçimit publik në fshatin Retijë.



Intervenimet emergjente në rrjetin e kanalizimit. Projekt i përfunduar.




Kompania e kontraktuar nga komuna është angazhuar në pastrimin e rrugës Zaqisht - Retijë.



Tabelat informuese për vendbanimet e komunës sonë.

Sinjalizimi horizontal dhe vertikal.

[BULETINI MUJOR KOMUNAL]



Kanë filluar punimet në instalimin e ndriçimit publik në rrugën "Bekim Isma" në Rahovec. Poashtu punimet në ndriçim publik po vazhdojnë në dy lagje të tjera në qytet si dhe në fshatin Retijë.



Kanë filluar punimet në zgjerimin e rrjetit te kanalizimit në fshatin Senoc.



Banorët e fshatit Gexhë po japid shembull se si duhet të kujdesemi për ambientin tonë. Parku i ndërtuar në vitin 2018 nga Komuna e Rahovecit, një investim i vogël, por shumë i rëndësishëm!




Këtë vit do të përfundojnë punimet e rregullimit të rrugëve me gurë në pjesën e vjetër të qytetit të Rahovecit. Momentalisht po punohet në vendosjen e kolektoreve për trajtimin e ujrale të zeza dhe kolektorit tjetër për ujrat atmosferikë dhe në ditët në vijim do të fillojë edhe shtruarja me gurë.

[BULETINI MUJOR KOMUNAL]



Drejtori i DSHP-së z.Samir Mustafa bashkë me Nënkyryetarin z.Fatmir Iska dhe Kryetarin e Fshatit Opterushë Skënder Krasniqi kanë bërë inspektimin e punimeve që po zhvillohen në ndërtimin e Qendrës së Mjeksisë Familjare i cili është investim nga Komuna e Rahovecit!



Vazhdojnë punimet në ndërtimin dhe asfaltimin e rrugës në fshatin Zaqisht.



Vazhdojnë punimet në ndërtimin e objektit të ri të shkollës "Liria" në Fortesë dhe sallës së edukatës fizike, projekt ky i financuar nga komuna jonë. Këto ditë po punohet në ndërtimin e kulmit dhe punët po ecin në përputhje me dinamikën e paraparë të projektit.

PËRFUNDIM

*Ky buletin përbledhës paraqet thekset kryesore të aktiviteteve që kanë ndodhur gjatë kësaj periudhe:
(shtator 2020).*

Edhe pse fusha e qeverisjes së mirë është mjaft e gjerë, një aspekt i rëndësishëm i saj që është i pashmangshëm për ta plusuar qytetarin në vend qendror është liria e informimit. Informacioni është themeli i qeverisjes së mirë, jo vetëm sepse e rrit efikasitetin por gjithashtu sepse i fuqizon qytetarët dhe mundëson shpërndarje të barabartë të përfitimeve nga zhvillimi i përgjithshëm në vend, andaj duke dashur që të jetë sa më transparente me publikun, Komuna e Rahovecit përmes këtij dokumenti kështu që ofruar një pasqyrë të përgjithshme të aktiviteteve të saj, përfshiu dhënë mundësi qytetarëve që të njohin e vlerësojnë punën e institucioneve komunale.

Komuna e Rahovecit ka vënë në funksion këto parime përmes formave të ndryshme të komunikimit me qytetarë, takimeve të drejtpeerdrejta, informimit publik dhe çfarëdo metode tjetër përmes së cilës transparenca të ndikojë në avancimin e vetëqeverisjes lokale.

Përveç konsultimit dhe komunikimit, këto dokumente forcojnë lidhjet e qytetarëve me komunën dhe rrisin besimin që e gjelqojnë zyrtarët publik në nivel lokal.

Rahovec, tetor 2020